



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 6

Prill 2018

SHTYLLA IV BASHKIMI EUROPIAN DHE INTEGRIMI

"Vala" e Ardshme e Anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE: Rasti i Shqipërisë
MSc./ LL.M. Kejsi ZIU

I. ABSTRAKT

Pjesa më e madhe e dy viteve të fundit kanë kontribuar dukshëm në rikthimin e "pyetjes Ballkanike" në krye të rendit të ditës të axhendës Europiane. Rruga drejt konsolidimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit për vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) – përfshirë këtu Shqipërinë – me qëllim anëtarësimin në Bashkimin Europian (BE) është ngarkuar vazhdimisht me vështirësi të shumta. Në ndryshim nga një rajon, emri i të cilit gjithnjë ka qenë i lidhur me një të kaluar të dhunshme dhe autoritare, një pjesë e konsiderueshme e politikës së jashtme të Bashkimit Europian ka qenë të krijojë dhe të kultivojë imazhin rajonal dhe global të një grupi vlerash demokratike, pozitive dhe të konsoliduara. Aktualisht, për shkak të krizave që përfshijnë populizmin në rritje në disa Shtete Anëtare të BE-së, kërcënimet terroriste, ndikimin e vazhdueshëm të Rusisë dhe të modelit islamik-autoritar turk në rajon – të ndryshëm nga modeli demokratik i garantuar nga NATO-ja - imazhi i BE-së si një lojtar global duket se është vënë në provë. Në këtë situatë, është e nevojshme që Bashkimi Europian të dëshmojë se është në gjendje për të zgjidhur problemet kryesore me të cilat përballet po kontinenti ynë dhe të rikthejë pozitën e tij të mëparshme në arenën botërore.

Në anën tjetër, vendet e Ballkanit Perëndimor mund ta perceptojnë këtë si kohën më të përshtatshme për të kapërcyer të ashtuquajturën "lodhje të anëtarësimit" (*enlargement fatigue*), e cila në rastin e Shqipërisë do të nënkuptonte hapjen zyrtarisht të negociatave të pranimit me BE-në. Por, a garanton fakti që Bashkimi Europian kohët e fundit duket të ketë (pak a shumë) braktisur qasjen e mëparshme të të "bërjes biznesi si zakonisht" në favor një strategjie më pragmatike dhe gjithëpërfshirëse zgjerimi, një përsheptim të besueshëm në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE? Për më tepër, cilat mjete të tjera strategjike duhet të përdorin BE-ja, në mënyrë që të promovojë më tej axhendën e integrimit të Shqipërisë?

Objektivi kryesor i këtij artikulli është të analizojë gjendjen e tanishme të Shqipërisë për sa i përket anëtarësimit të mundshëm në BE, duke shqyrtuar arritjet aktuale të vendit dhe sfidat e mbetura, si dhe kushtëzimin politik të Evropës në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Fjalë kyçe: *axhenda e integrimit në BE, Komisioni Europian, Ballkani Perëndimor, sundimi i ligjit, demokratizimi, Strategjia e Zgjerimit të Ballkanit Perëndimor, etj.*



SHKURTIME

BE	Bashkimi Europian
BP	Ballkani Perëndimor
BP 6	Gjashtë Vendet e Ballkanit Perëndimor
ShA	Shtetet Anëtare
OShC	Organizata të Shoqërisë Civile
MSA	Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit

II. HYRJE

Siç u përmend më sipër, Bashkimi Europian duket se po devijon nga qëndrimi i mëparshëm "*at arm's length*" i mbajtur ndaj Shqipërisë dhe Ballkanit Perëndimor në përgjithësi, duke pakësuar gjuhën e zakonshme diplomatike, si dhe duke përcaktuar vitin 2025 si afat kohor potencial kur Shtetet e tanishme Anëtare mund të rriten në numër. Presidenti i Komisionit Europian J. Juncker - në fjalimin e tij mbi Gjendjen e Unionit në vitin 2017¹ dhe më vonë, pas publikimit të Strategjisë të Zgjerimit "*Një perspektivë e besueshme zgjerimi për dhe angazhim më të madh të BE-së me Ballkanin Perëndimor*"² - ndryshe nga herët e tjera, përmendi një perspektivë të qartë kohore për pranimin në Bashkimin Europian të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke synuar përfundimisht ndërtimin e një "Evrope më demokratike për 2025".³ Bullgaria mori në drejtim Presidencën gjashtëmujore të BE në fillim të vitit 2018⁴ dhe më e rëndësishmja, në 17 Prill 2018 Komisioni Europian i dha zyrtarisht rekomandimin e tij Këshillit Europian për të

¹ Shih Fjalimin e Presidentit të Komisionit Europian Jean-Claude Juncker mbi Gjendjen e Unionit, "Anëtarësimi i Ballkanit Perëndimor: Destinacion i Përbashkët", 13 Shtator 2017, gjendet në https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/western-balkans-enlargement_en.pdf

² Shih Komunikatën e Komisionit drejtuar Parlamentit Europian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Europian dhe Komitetit të Rajoneve, "Një perspektivë e besueshme anëtarësimi dhe angazhim i shtuar i BE-së me Ballkanin Perëndimor", Strasburg, 6.2.2018 COM(2018) 65 final. Gjendet në https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf

³ *Ibid.*, fq.2 dhe 8.

⁴ Roli i shtetit që merr në drejtim Presidencën është që, në bashkëpunim me Komisionin Europian, të koordinojë / menaxhojë politikat dhe aktivitetet e Bashkimit Europian. Në lidhje me negociatat e anëtarësimit midis BE-së dhe vendeve candidate si Shqipëria, është detyra e vendit që mban Presidencën të përcaktojë axhendën dhe kalendarin e vendimmarrjes mbi këtë çështje, kështu që Shqipëria apo vende të tjera candidate mund të ndikojnë në dinamikën e këtyre negociatave. Shih gjithashtu "Sesioni II: Përshpejtimi i reformave në kuadër të perspektivës evropiane për Ballkanin Perëndimor", Konferenca Ndër-parlamentare mbi Politikën e Jashtme të Përbashkët dhe të Sigurisë (PJS) dhe Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PPSM), Sofie, 15-17 Shkurt 2018. Shih gjithashtu Fjalimin e Ekaterina Zaharieva, Zv. Kryeministrja për Reformën Gjyqësore dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Bullgarisë, "Axhenda e Ballkanit Perëndimor është e gjithë Evropës: E Nesër mja jonë është e përbashkët", 14.02.2018. E lexueshme në <https://europeanwesternbalkans.com/2018/02/14/western-balkans-agenda-whole-europe-tomorrow-shared/>



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL ♦ Numri 6 | Prill 2018

hapur negociatat e pranimit me Shqipërinë, të gjitha këto elementë të cilët mund të interpretohen si shtysa për forcimin e perspektivës Europiane të Shqipërisë.⁵ Megjithatë, për hir të këtij diskutimi, është e rëndësishme të analizohet nëse qëndrimi i Komisionit lë vend për të qenë optimistë se anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian është e prekshme deri më 2025. Së pari, legjitimiteti politik i negociatave të pranimit për Shqipërinë duket të jetë në lëkundje: disa prej Shteteve Anëtare⁶ nuk kanë shprehur shumë entuziazëm për të mbështetur rekomandimet e Komisionit për hapjen e negociatave të pranimit, element i cili për disa mund të interpretohet si sinjal lidhur me fatin që do të ketë votimi i ardhshëm i Këshillit në Qershor 2018.

Së dyti, si Strategjia e Zgjerimit, ashtu dhe Raporti i Progresit të Komisionit për Shqipërinë për vitin 2018⁷, vazhdojnë të vënë në pah sfidat e mbetura strukturore lidhur me sundimin e ligjit në vend, që përbën pengesën kryesore në progresin e mëtejshëm të këtij të fundit. Pavarësisht përgëzimit për zbatimin të reformës më të fundit gjithëpërfshirëse në sistemin e drejtësisë⁸, në Raportin e 2018 thuhet qartë se Shqipëria ka ende nevojë të thellojë reformat për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.⁹

Përkundër rekomandimit zyrtar të Komisionit për të hapur negociatat e pranimit dhe precedentit të ri në dukje, të vendosur në Strategjinë e Zgjerimit 2018, është e rëndësishme të argumentohet se çfarë duhet të nënkuptojë kjo Strategji për të gjithë palët e përfshira: nga njëra anë, përafrimin

⁵ Shih Fjalimin e Mogherinit në konferencën e përbashkët për shtyp me Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë, 18.04.2018. E aksesueshme në https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/43127/remarks-hrvp-mogherini-joint-press-conference-edi-rama-prime-minister-albania_en. Për më shumë informacion, shih gjithashtu Fjalimin e mbajtur nga F. Mogherini në eventin "Shqipëria: Përkushtuar ndaj reformës" në Parlamentin Europian, Bruksel, 20.03.2018. Gjendet në https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/41721/speech-high-representative-vice-president-federica-mogherini-event-albania-committed-reform_en dhe "Mogherini: Shqipëria e gatshme për të hapur negociatat, duke ruajtur dhe thelluar reformat e mbetura", gjendet në https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/43154/mogherini-albania-ready-open-negotiations-maintaining-and-deepening-reforms-ahead_en

⁶ Franca dhe Gjermania e kanë kundërshtuar kohët e fundit zgjerimin e mëtejshëm të BE me vendet e Ballkanit Perëndimor. Shih për shembull <http://www.dw.com/en/frances-emmanuel-macron-calls-for-revival-of-eu-democracy/a-43415579>

⁷ Shih Dokumentin e Stafit të Komisionit Europian "Raporti i vitit 2018 i shoqëruar me dokumentin Komunikatë nga Komisioni në Parlamentin Europian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Europian dhe Komitetin e Rajoneve 2018 Komunikatë mbi Politikën e Zgjerimit të BE", SWD (2018) 151 final, Strasburg, 17.4.2018, e aksesueshme në <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>. Shih gjithashtu "Gjetjet kryesore të Raportit 2018 për Shqipërinë", Komisioni Europian - Fletë Informative, Bruksel, 17 Prill 2018. E aksesueshme në http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-18-3403_en.htm ;

⁸ Shih Ligjin Nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Ende pa hapur negociatat për anëtarësim, Komisioni i ka kërkuar Maqedonisë dhe Shqipërisë të zbatojnë reforma të cilat Serbia dhe Mali i Zi nuk i kanë përfunduar ende.

⁹ Shih për shembull fq.40-43 të Progres Raportit të Komisionit për Shqipërinë për vitin 2018, *ibid*.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 6

Prill 2018

e mëtejshëm të standardeve të Shqipërisë me ato europiane dhe nga ana tjetër, forcimin e angazhimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, duke ofruar një perspektivë konkrete anëtarësimi për secilin vend të rajonit.

III. VLERËSIM I NATYRËS KOMPLEKSE TË MEKANIZMAVE AKTUALE TË ANËTARËSIMIT NË BE

Për qëllim të këtij artikulli, seksioni vijues nuk do të përqendrohet në shpjegimin e mekanizmave aktualë të anëtarësimi (kriteret e Kopenhagenit dhe kriteri i kushtëzimit) në detaj, por synon të diskutojë pengesat e mundshme që këto kritere mund të krijojnë përgjatë rrugës së Shqipërisë drejt anëtarësimi në BE.

Së pari, konceptet që përcaktojnë një prej kritereve të Kopenhagenit - atë politik - të tilla si demokracia, shteti i së drejtës, të drejtat e njeriut dhe garancitë mbrojtëse që Bashkimi European kërkon që çdo vend kandidat t'u përmbahet si kusht për anëtarësim, janë ato që përmenden më shpesh në Raportet vjetore të Progresit që nxjerr Komisioni për të vlerësuar ecurinë e çdo vendi aspirant. Raporti më i fundit i Progresit për Shqipërinë theksonte gjithashtu se vlerat më themelore përfshijnë sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Megjithatë, këto terma ndoshta mund të interpretohen si të paqarta dhe shumë të përgjithshme, që mund t'i shërbejë BE-së si armë për tejzgjatjen ose pezullimin e negociatave për anëtarësim me këto vende në çdo kohë, nëse e vlerëson si të nevojshme. Autorja është e mendimit se edhe Progres Raporti i 2018, në mënyrë të ngjashme me Raportet e viteve të kaluara, nuk duket të përcaktojë një perspektivë konkrete anëtarësimi për vendin, të paktën në një të ardhme të afërt.¹⁰ Megjithëse Raporti konstaton një progres mesatar të reformës së sistemit gjyqësor dhe administratës publike - të konsideruara themelore për arritjen e mirëqeverisjes dhe sundimit të ligjit - vë në dukje nevojën për përparim të mëtejshëm në zhvillimin e një ekonomie funksionale tregu dhe harmonizimin e legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire* në disa fusha.¹¹ Komisioni European historikisht ka zgjedhur të mos vendosë afate për përmbushjen e kritereve të Kopenhagenit, duke mos lejuar në këtë mënyrë shumë hapësirë për Shqipërinë apo vendet e tjera kandidatë që të kenë ndikim në afatin kohor të anëtarësimi apo të negociojnë lidhur me kushtet e tij. Për më tepër, BE-ja ka demonstruar që favorizon më tepër stabilitetin dhe sigurinë rajonale kundrejt kritereve të natyrës ligjore dhe politike. Kjo mund të shihet në MSA-t¹² e lidhura me

¹⁰ Për informacion të mëtejshëm, shih për shembull Marko Kmezić, "EU Western Balkans Strategy: On Named and Unnamed Elephants in the Room", 12.02.2018. Material i aksesueshëm në <http://www.biepag.eu/2018/02/08/eu-western-balkans-strategy-on-named-and-unnamed-elephants-in-the-room/>

¹¹ Shih fq.60 – 63 i Progres Raportit të Komisionit European për Shqipërinë 2018, *supra cit.*

¹² Shih për shembull Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit ndërmjet Komuniteteve Europiane dhe Shteteve të tyre Anëtare nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, L 107/166, 28.04.2009. E aksesueshme në [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/PDF/?uri=CELEX:22009A0428\(02\)&rid=1](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/PDF/?uri=CELEX:22009A0428(02)&rid=1).



secilin vend kandidat^k u përcaktohen kushtëzimet specifike, ose thënë ndryshe, përcaktohet kriteri i kushtëzimit. Për shembull, pavarësisht se Serbia dhe Mali i Zi - dy kandidatët kryesorë për anëtarësim në BE - vazhdojnë të kenë sfida në respektimin e sundimit të ligjit dhe ende nuk kanë përfunduar reformat e nevojshme për ta adresuar këtë problem¹³, Komisioni i vendosi Shqipërisë kushtin për të zbatuar reformën e vettingut përpara dhënies së rekomandimit dhe pa marrë parasysh se Këshilli European ende s'ka dhënë dritën jeshile për hapjen e negociatave të anëtarësimit.¹⁴

Dinamika në ndryshim e dy instrumenteve kryesorë për anëtarësim të BE, e diskutuar më sipër, ka mundësi të përdoret si municion nga disa Shtete Anëtare për të anashkaluar progresin e një vendi anëtar si Shqipëria. Siç u dëshmuua nga fjalimi i Presidentit francez Emmanuel Macron – i mbajtur vetëm disa orë pas publikimit të rekomandimit të Komisionit për hapjen e negociatave - Franca dhe Gjermania, dy aktorët kryesorë në hartimin e politikës së jashtme të Unionit janë aktualisht të përqendruar në reformimin e bllokut në madhësinë e tij aktuale, pa patur plane të afërta zgjerimi.¹⁵ Rrjedhimisht, është e parakohshme të thuhet nëse reformat aktuale në Shqipëri kanë mjaftuar për të “merituar” anëtarësim të plotë deri në vitin 2025. Është e nevojshme që BE-ja të ofrojë mjete shtesë në dispozicion për të kryer reformat transformuese për të cilat Shqipëria ka nevojë, sepse nuk duhet të harrojmë që për të siguruar që një strategji e re të japë rezultate, duhet të përfshijë sisteme të fuqishme monitorimi dhe zbatimi. Reformat funksionojnë vetëm nëse ato zbatohen në një mënyrë të besueshme dhe të qëndrueshme, mundësisht përpara se Shqipëria t'i bashkohet familjes Europiane. Kjo do të ishte një dëshmi serioze e rritjes së angazhimit të BE-së në Shqipëri dhe në vendet e rajonit, si dhe forcim i pozitës së saj udhëheqëse në arenën globale. Mjetet që BE mund të vendosë në dispozicion do të diskutohen në seksionin e mëposhtëm.

IV. KOHA PËR TË RRRITUR STANDARDIN: DREJT NJË EPOKE TË RË TË "DIPLOMACISË BALLKANIKE"

IV.1. Rishikim i Procesit të Berlinit (?)

¹³ Shih “Gjetjet kryesore të Progres Raportit të 2018 për Serbinë”, Komisioni European - Fleta Informativë, e marrë më 17 prill 2018. Aksesohet në http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-18-3406_en.htm

¹⁴ Një shembull tjetër i mirë do të ishte rasti i Kroacisë, kur Bashkimi European fillimisht i pezulloi negociatat e anëtarësimit me qëllim që të detyronte pajtimin e Kroacisë me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Megjithatë, Bashkimi Evropian nuk ka ndërmarrë masa të tilla të forta për Shqipërinë, element që mund të dëshmojë për një zbatim jo konsistent të kriterit të kushtëzimit, lidhur me masat serioze të marra vetëm për ato vende që Bashkimi Evropian dëshiron të aderojë shpejt. Për informacion të mëtejshëm, shih G. Stafaj, “From Rags to Riches: Croatia and Albania’s EU Accession Process through the Copenhagen Criteria and Conditionality”, Revista Ndërkombëtare Për të Drejtën Ndërkombëtare Fordham, Volumi 37, Numri 5, 2014, 8.

¹⁵ *Ibid.*, shih <http://www.dw.com/en/frances-emmanuel-macron-calls-for-revival-of-eu-democracy/a-43415579>



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 6

Prill 2018

Hapi i parë në drejtimin e duhur do të ishte të rritej numri i investimeve ekonomike në Shqipëri, në mënyrë që të përafrohej niveli mesatar i zhvillimit ekonomik të Shteteve Anëtare të BE-së me atë të vendit tonë. Pavarësisht implementimit të IPA-s¹⁶ në Shqipëri dhe në pjesën tjetër të rajonit, çështja e zhvillimit ekonomik ende paraqet një problem akut për të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe deri më tani, mbështetja financiare për zhvillim strukturor prej Bashkimit Europian është rezervuar ekskluzivisht për Shtetet Anëtare. Një strategji integruese dhe e besueshme anëtarësimi duhet të ofrojë zgjidhje krijuese dhe të sigurojë trajtim të ngjashëm për vendet kandidatë në përcaktimin e kushteve të nevojshme për përdorimin e kësaj mbështetje. Në këtë kuptim, dëshmia më e mirë e gatishmërisë e BE-së ndaj rajonit do të ishte akordimi i fondeve financuese për vendet kandidatë (si Shqipëria) në Kornizën e ardhshme Financiare Shumëvjeçare të BE-së (buxheti afatgjatë i BE-së).¹⁷ Ky veprim do të kishte një efekt pozitiv motivimi për vendin tonë dhe vendet e tjera për të ndërmarrë të gjitha reformat e nevojshme për të përfituar nga kjo mundësi.

Së dyti, Procesi i Berlinit¹⁸ ka rezultuar mjaft i suksesshëm në misionin e të qenit një nismë bashkëpunimi (më së shumti politik) rajonal, që plotëson hendekun e procesit të anëtarësimit. Megjithatë, pavarësisht se ka sjellë një shtysë pozitive dhe të pamohueshme për “BP 6”, autorja është e mendimit se një përmirësim i mëtejshëm i procesit të Berlinit do të mirëpritej¹⁹, në mënyrë që të arrihet një konvergencë ekonomike më e madhe rajonale, nëpërmjet rritjes së përfshirjes financiare të BE-së. Në një situatë të tillë, BE-ja mund të ofrojë mjete bashkëpunimi dhe zhvillimi të cilat janë të drejtuara më mirë ndaj nevojave të rajonit të Ballkanit (p.sh. krijimi i fondeve të posaçme për start-ups, trajnime profesionale, zhvillimi i infrastrukturës së IT, etj.), ose thënë ndryshe, duhet t’u japë prioritet ideve që gjenerojnë përmirësime të dukshme dhe synojnë ta kthejnë rajonin në një zonë më tërheqëse ekonomike. Muaji Maj 2018 ndoshta do të japë disa indikacione se deri në çfarë mase BE-ja po planifikon të rrisë angazhimin financiar dhe të përgjithshëm në rajon²⁰, pasi ky muaj shënon Samitin e ardhshëm ndërmjet BE-së dhe

¹⁶ Instrumenti i Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA) është mjete me të cilin BE-ja mbështet reformat në 'vendet e zgjerimit', me ndihmë financiare dhe teknike. Fondet e IPA ndërtojnë kapacitetet e vendeve gjatë gjithë procesit të anëtarësimit. Për periudhën 2014-2020, alokimi i fondeve të BE për Shqipërinë është deklaruar të jetë 649.4 milionë euro. Shih gjithashtu https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/instruments/funding-by-country/albania_en

¹⁷ Shih http://ec.europa.eu/budget/mff/index_en.cfm

¹⁸ Me pak fjalë, Procesi i Berlinit është një iniciativë diplomatike që lidhet me procesin e ardhshëm të zgjerimit të Bashkimit Evropian. Ka filluar me Konferencën e 2014 të Shteteve të Ballkanit Perëndimor në Berlin, pasuar nga Samiti i Vjenës i vitit 2015 dhe Samiti i Parisit në 2016.

¹⁹ Për më shumë informacion, shih Erwan Fouéré, Steven Blockmans, “The ‘Berlin Process’ for the Western Balkans – Is it delivering?”, Qendra për Studime të Politikave Evropiane, 13 Korrik 2017.

²⁰ Shih vërejtjet e Presidentit të Këshillit Europian Tusk pas takimit të tij me kancelarin federal austriak, Sebastian Kurz, 13 Shkurt 2018, gjendet në <http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2018/02/13/remarks-by-president-donald-tusk-after-his-meeting-with-austrian-federal-chancellor-sebastian-kurz/>



vendeve të Ballkanit Perëndimor në Sofje, Bullgari. Synimi përfundimtar i Samitit është të ofrojë mundësi për të shfaqur shtrirjen e marrëdhënieve BE - Ballkan Perëndimor përtej thjesht aspekteve ndër-qeveritare.²¹

IV.2. Përfshirja e shoqërisë civile shqiptare

Ofrimi i asistencës së BE-së ndaj organizatave të shoqërisë civile (OSHC) deri më tani ka kontribuar ndjeshëm në transformimin e rajonit të Ballkanit. Megjithatë, përpjekja edhe më e madhe për përfshirjen e mëtejshme të shoqërisë civile në Shqipëri – në kuptim të kanaleve të komunikimit të BE-së me rajonin - është shumë e nevojshme. Rrjedhimisht, Komisioni European duhet të përqendrohet në ndërtimin e kanaleve të fuqishëm të komunikimit me OShC-të, krahas atyre të tashmë të krijuara me aktorë shtetërorë dhe qeveritarë, veçanërisht me ato OShC që kanë dëshmuar aftësi për të mobilizuar qytetarët për çështje kritike të drejtësisë, demokracisë apo integritimit european, në nivel kombëtar dhe rajonal. Nevoja për këtë lloj bashkëpunimi është akoma më e rëndësishme në fazën aktuale, kur Shqipëria shpreson të hapë negociatat e pranimit me Bashkimin European.

IV.3. Përfshirja e mëtejshme e Shqipërisë në "punët" e BE-së

Komisioni European duhet të mendojë për mënyra të mundshme sesi të përfshijë vende kandidatë si Shqipëria në politikë-bërjen e Unionit, për fusha të ndryshme. Pavarësisht se është e qartë se Shqipëria nuk do të ishte në pozitë të marrjes pjesë në çdo lloj vendimmarrjeje në të njëjtin nivel me vendet anëtare të BE-së, është e mundur të përcaktohet një angazhim i mundshëm i saj në konsultimet rreth krijimit dhe zhvillimit të politikave të përbashkëta që do të ishin reciprokisht të dobishme. Në këtë mënyrë do të sigurohej një nivel më i lartë i integritimit të vendeve kandidatë në fusha të tilla si tregtia, infrastruktura, migracioni, çështjet për sigurinë e brendshme dhe sundimin e ligjit, apo në politikat e kushtuara kërkimeve shkencore, arsimit për qytetarët e BE-së, etj.

Për më tepër, përfshirja e përfaqësuesve politikë shqiptarë në organe të ndryshme të BE-së (p.sh. Këshilli European), sado modeste, do të kontribuonte në një perceptim më të qartë të funksionimit të Unionit dhe në një zbatim më të mirë të politikave dhe vlerave të përbashkëta të BE nga këta agjentë shtetërorë në të ardhmen. Kjo do të shërbente gjithashtu si një mesazh i qartë për vendet e tjera (p.sh. Rusia, Kina, etj.) të investuara në këtë pjesë të Evropës për arsye të ndryshme ekonomike, strategjike dhe / ose politike, që vendet kandidatë të Ballkanit tashmë janë pjesë "de facto" e BE-së dhe se anëtarësimi i tyre në të ardhmen nuk vendoset më në dyshim.

²¹ Nuk është rastësi që Bullgaria do të jetë vendi pritës për Samitin e BE-së dhe Ballkanit Perëndimor më 17 Maj, në 15 vjetorin e Samitit të Selanikut, Greqi, ku Shtetet Anëtare premtuan për herë të parë të ndërmarrin përsipër angazhim në rajonin e Ballkanit.



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL

Numri 6

Prill 2018

V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Seksioni i fundit pasqyron disa vërejtje përfundimtare dhe sugjerime të mundshme për Shqipërinë dhe Bashkimin European, si më poshtë:

A. *Për Shqipërinë:*

- i. Pavarësisht çështjeve të diskutuara më sipër, që kanë të bëjnë me mekanizmat e anëtarësimit të cilave vendet candidate duhet t'u përmbahen, është i pamohueshëm fakti se për arsye të qarta, e ardhmja e Shqipërisë (dhe e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor) lidhet në mënyrë të pakthyeshme me Bashkimin European. Megjithatë, kanë kaluar pothuajse 10 vjet që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe zhvillimi i tanishëm i përgjithshëm i Shqipërisë mbetet ende larg nga të fituarit një perspektivë të vërtetë anëtarësim, për shkak të sfidave të mbetura në kryerjen e procesit të demokratizimit. Ekzistenca e një sistemi demokratik që kundërshton çdo lloj ndikimi të paligjshëm apo korrupsioni është me rëndësi vendimtare për pranimin në BE, por siç thekson Raporti i Progresit i vitit 2018, krijimi i një rekordi të qëndrueshëm të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit, si dhe krimet të organizuar ende duhet të arrihen plotësisht dhe kërkojnë përpjekje të mëtejshme të strukturuar dhe të vazhdueshme.
- ii. Në të tilla rrethana, Shqipëria është e nevojshme që të demonstrojë një model të qartë të rëndësisë që ka procesi të integrimit në BE, nëpërmjet adresimit sa më të shpejtë të këtyre problematikave. Duke marrë parasysh se faza më e vështirë dhe më e vështirë e Shqipërisë në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin European në këtë moment qëndron në bindjen e qeverive të Shteteve Anëtare për të dhënë përparimet e tyre në lidhje me rekomandimin e Komisionit të BE për hapjen e negociatave për anëtarësim, është vendimtare që autoritetet e vendit të ndërmarrin përgjegjësi dhe të japin rezultatet e kërkuara.

B. *Për Bashkimin European:*

- i. Së pari, BE-ja duhet të bëjë më shumë sesa thjesht të përcaktojë afatin kohor dhe një perspektivë të mundshme anëtarësimi për dy kandidatët kryesorë deri në vitin 2025. Përkundrazi, për hir të motivimit të secilit prej vendeve të tjera candidate që aspirojnë të ecin përpara me proceset përkatëse të reformave, Unioni duhet të ndjekë një *qasje individuale* për procedurat e anëtarësimit me secilin prej tyre, duke vepruar në mënyrë të ngjashme si modeli i Kroacisë, disa vite më parë. Rrjedhimisht, në rastin e Shqipërisë, është e nevojshme që BE-ja të përcaktojë një afat të qartë kohor për vlerësimin e arritjeve të vendit dhe ecurinë e hapave të ardhshëm lidhur me procesin e pranimit. Kjo është gjithashtu e rëndësishme për shkak të detyrimit që ka Komisioni European për të vlerësuar, në një



ALBANIA

Law Journal

ISSN 2523-1774

LAWJOURNAL.AL ♦ Numri 6 | Prill 2018

moment të caktuar, efektet e pranimet në BE në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, i cili përbën një nga kushtet për çdo zgjerim të kryer në BE.

- ii. Duke marrë parasysh të gjitha ato që u diskutuan më lart, Unioni nuk duhet të hezitojë pa qenë nevoja, për të hapur negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë, maksimumi deri në fund të vitit të ardhshëm. Shumë sfida mbeten ende, por viti 2018 premtion dinamika të reja në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Europian. Angazhimi i ripërtërirë i këtij të fundit, nëse mbështetet me vendosmëri të fortë kombëtare për të kryer reforma, mund të japë kontribute të dukshme në rrugën e Shqipërisë dhe të çdo shteti tjetër në Ballkanin Perëndimor drejt anëtarësimit.